Kryeministri cullak f.2

Live nga Kafe
me Rektorin f.4

Shporta e Studentit f.7

Mendoj f.12

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 05 / KORRIK 2019



editorial



Rron Gjinovci

KRYEMINISTRI CULLAK

Nuk ka mundësi që editoriali i gazetës që del në të njejtin muj me dorëheqjen e kryeministrit mos me kenë editorial urues e entuziast. Prandej, urime dorëheqja e kryeministrit! Gazmende të tilla paçim gjithmonë ishalla!

Në raste të tilla si dorëheqja e nji kryeministri, gazetat zakonisht shkrujnë për pozitivetin dhe negativetin e qeverisjes. I urojmë shumë suksese cilësdo gazetë që mundohet me i nxjerrë të mirat e qeverisjes që na la, ndërkohë që na po e shënojmë momentin ma të randë të kësaj qeverije në arsim.

Nji prej vendimeve të para të kryeministrit dhe në pikëpamjen tonë ma i keqi, është shkarkimi i Këshillit Shtetnor të Cilësisë disa javë mbas marrjes së pushtetit më 2017, i cili rezultoi me përjashtimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) nga EQAR (Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Naltë). Fill mas përjashtimit, AKA u degradu nga "anëtar" në "anëtar nën vëzhgim" në ENQA (Asociacion Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsimin e Naltë). Këto dy entitete evropiane ishin të vetmet ku Kosova bënte pjesë. Në fakt ishin edhe momente krenarie për Kosovën pasi Kosova ishte e vetmja nga shtetet fqinje me traditë shumë ma të gjatë në arsimin e naltë, që ishte pjesë e këtyre dy entiteve, me përjashtim të Serbisë e cila po ashtu bën pjesë në to.

Të qenët në këto entitete bën që diplomat e lëshume prej institucioneve të arsimit të naltë në Kosovë me kenë ma të vlefshme e ma të besushme për botën mbarë e sidomos për atë që quhet "Hapësina Evropiane e Arsimit të Naltë", çka ndikon drejtpërsëdrejti në jepjen ma të lehtë të bursave dhe lehtësime tjera të ngjashme për studentat e Kosovës. Përjashtimi nga to do të sjellë probleme të reja të prekshme si probleme të ndryshme administrative, por ma me randësi, do ta sillte kolapsin përfundimtar të cilësisë në institucionet e arsimit të naltë që veprojnë në Kosovë e që edhe ashtu janë boll të lodhta.

Shkarkimi i atij Këshilli qe nji moment i madh kthese i qasjes së organizatave të shoqnisë civile që veprojnë në Kosovë, të cilat përveç kritikës së ashpër ofrun edhe bashkëpunim dhe arritën që mbas kësaj katrahure me siguru nji proces transparent për zgjedhjen e anëtarëve të ri të Këshillit Shtetnor të Cilësisë. Ndoshta kjo ishte hera e parë që nji trupë kaq e randësishme nuk qe e mbushun me militantë partish, por me njerëz të cilët me vendimet që morën qysh prej emërimit e deri sot, tregun se kishin integritet të naltë moral e profesional.

Gabimi i kryeministrit në njanën anë dhe mençuria e organizatave të shoqnisë civile në anën tjetër, të cilat vendosën jo veç me ndejt e me sha prej skajeve, por me u përfshi për me zgjidh çashtjen, i kushtoi kryeministrit dhe qeverisë me disa probleme e disa kokëdhimbje. Kjo sepse Këshilli i zgjedhun çakreditoi dhjetëra programe në institucione publike e private dhe filloi që llomin e arsimit të naltë me e pastru nga komercializmi. Qindra programe të akreditume në Kosovë dul se nuk i plotësonin kushtet ma bazike dhe debate të mëdha u zhvillun në shoqninë tonë. Natyrisht të gjithë kritikonjësat e Këshillit fshiheshin mbas "interesit nacional" për vazhdimin e programeve në universitete publike, mirëpo dhimta e madhe janë qartazi institucionet private të arsimit të naltë, këto biznese të cilat po bajnë kërdi në cilësinë e arsimit qe vite të tana në Kosovë.

Së fundi Këshilli Shtetnor i Cilësisë vendosi me i çakreditu edhe 3 universitete publike e 6 institucione private të arsimit të lartë. Kryeministri bani gabimin e dytë. Në nji drejtim publikut ai i shau anëtarët e Këshillit duke i qujtë "mafiozë" e "mercenarë" e duke u thirrë në fmijët e vorfun të Kosovës që kanë kry maturën, por që nuk munden me ardhë e me studiu në Prishtinë për shkak të vorfnisë. A thu se ishte përgjegjsi e ne publikut me u marrë me vorfninë. A thu se shkaktarë të vorfnisë së tyne ishim na publiku e jo korrupsioni i qeverisë së tij që gurgullon pajada te enturazha e tij prej dhjetëra ministrash e ma shumë se 200 zavendës ministrash.

Kësi hovi kryeministri ishte cullak. Përveç që nuk lam asnji mundësi pa i tregu publikut të vërtetën, pra që dhimta është te kolegjet private qi përfitojnë miliona Euro e qi mandej i ndajnë me politikanët, po ashtu i njoftum me shpejtësi krejt akterët e tjerë vendor e ndërkombëtar. Dhe nuk shkoi gat, iniciativa e tij për me i shti durt edhe njiher në Këshillin Shtetnor të Cilësisë u godit nga pothuejsa tana mediet e tan' akterët. Shkoi deri aty sa edhe ambasadorat e Amerikës, Evropës dhe Britanisë së Madhe iu kundërvunë hapun kësaj ndërhymje në pavarësinë e Këshillit.

Në anën tjetër na ishim krejt të gatshëm për protestë. E qe besa edhe të kthjellum paksa. E kuptum që politikanëve si puna e ktyne që i kemi na në dispozicion, nuk u besohet, dhe se çfarëdo bashkëpunimi me ta në dukje i frytshëm, duhet me u përcjellë përherë me shtrimin e nji rrjeti organizativ. Në rastet kur politikanëve ju bahet bajat bashkëpunimi me ne dhe donë me shty përpara interesat e bizneseve private në arsim, na me kenë në gjendje me ju kundërvy shpejtë, ashpër dhe sa ma llahtarshëm që të jetë e mundun.



Redaksia dhe bashkëpunëtorët:
Adea Kondirolli
Etnik Jakupi
Indrit Ferati
Zogë Hasani
Valon Dervishaj
Vesel Veseli
Basri Oruqaj
Dibran Hoxha
Sara Sylejmani
Lyra Hoxha
Skord Retkoceri
~~Gramos Buçinca~~
Rron Gjinovci

Dizajni:
Visar Arifaj - Kabineti

Kontakti:
www.orca-ks.org
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky publikim është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

TEMPULLI I DIJES • KORRIK 2019, NUMRI 05

Live nga Kafe me Rektorin (FOTO)

Korrespondenti ynë Valon Dervishaj ka pasur fatin të përzgjedhet për kafenë e përmuajshme me Rektorin. Pjesa tjetër e Redaksisë së TD-së ishte e mërzitur që nuk kanë qasje në këto takime të frytshme, dhe vendosëm me intervistu fatlumin.

Ndiqni këtë intervistë të zhvilluar nga redaktori për korrespondenca Indrit Ferati, për takimin e kafeinizuar mes absolventëve dhe Rektorit në Ditën Kombëtare të Selfieve (cit. Universiteti i Prishtinës).



Valon Dervishaj

Indrit Ferati: *Kemi dëgjuar disa thashetheme nga burime të ndryshme se rektori paraqitet në TV me më shumë kg sesa në realitet. A është e vërtetë?*

Valon Dervishaj: Mund të pajtohem pjesërisht me këto thashetheme. Në të vërtetë Rektori shquhet për vitalitetin fizik dhe shëndetin e tij në përgjithësi. Ndoshta kohëve të fundit ka mund të shtojë ndonjë kilogram.. Kjo nuk dukej në fillim pasi Rektori qëndrojke ulur në shilte me dy këmbë në tokë mirepo pas disa momentesh ai vendosi këmbën mbi këmbë dhe iu vërejt pak abdomeni i plotësuar.

IF: *Rektori Dema a ka jepur leksione për studentët që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet nacionale, pasi ky i fundit ka eksperiencë?*

VD: Në asnjë mënyrë! Të gjithë e dijmë të kaluarën politike të Rektorit dhe për këtë të gjithë jemi krenar. Rektori Dema ishte po aq i suksesshëm në politikë sa është edhe në jetën akademike e në drejtim dhe menaxhim të UP-së. Mund të them se ajo përvojë vetëm sa i ka ndihmuar Rektorit në përgatitjen e tij profesionale e akademike. Detyra e tij e kufizon në këtë drejtim...ai duhet të qendrojë larg politikës, gjë që është duke e bërë prej fillimit të mandatit. Përkundrazi, ai bëri një tërheqje taktike do të thoja, kur në diskutim u fut tema e politikës, kryesisht në sferën e partive studentore dhe politizimin e tyre. Kështu që jo.

IF: *Me sa sheqera e pinte rektori kafen?*

VD: Me gjasë Rektori nuk është ndonjë adhurues i flaktë i kafesë, e aq më pak i atyre kafeve të Bufesë së Biblotekës Kombëtare. Kjo dukej qartë nga mimika e tij pasi e provoi pak kafenë. Në mendjen time dicka m'thojke që Rektori do të preferonte më shumë një gotë verë apo thjesht ishte i kënaqur vetëm me shishen e ujit që e shoqëronte kafenë. Sheqeri ishte brenda kafesë dhe çka na mbeti neve ishte vetëm ta përzienim. Sipas gjykimit tim kafeja përmbante diku tri-katër lugë të vogla sheqer.

IF: *A ishte provokativ për rektorin leshi i gjoksit i Afrim Muqiqit?*

VD: Rektori foli edhe për absolventiadat pas pyetjeve të studentëve. Ai preferonte më shumë angazhimin e studentëve dhe këshilleve studentore në organizimin e tyre dhe të fotografimeve panoramike (Pano). Diskutimi nuk shkoi deri në detaje të tilla mirëpo u cek mënyra e organizimit dasmor i cili ekziston tani dhe mundësia që në të ardhmen këto të organizohen nga vet Rektorati, duke parë dhe analizuar edhe anën ekonomike të tyre. Po me sa kam dëgjuar Rektori Dema është adhurues i këngëtarit Afrim Muqiqi.

IF: *Mos ras'sisht rektori kishte ndonjë plan për zhvillimin e universitetit?*

VD: Rektori foli për vazhdimsinë e punës së mirë që po bëhet tash me shumë se dy vjet. Ai u përqendrua në përmirësimin e politikave arsimore afatmesme dhe afatgjata. Nuk dëgjuam për ndonjë projekt të madh për ndryshim rrënjësor në UP, mirëpo Rektori ndjek politika të sigurta në këtë drejtim. Ndryshim po vjen ngadalë por i sigurtë (hahahahha). Pika pika mushet pusi.

IF: *Sa pare i kishe jep ti Valon për me u bo rektor?*

VD: Jo vetem para, po do të jepja çdo gjë që kam vetëm të bëhem Rektor një ditë.

IF: *Gjatë takimit, a kishte ndonjë student që fliste pa i'a jep fjalën rektori?*

VD: Edhe pse ai preferonte mënyrën e diskutimit me radhë, duke dëgjuar njëri tjetrin deri në fund, pati disa herë ndërhyrje nga studentët, por edhe nga ana e Rektorit. Kjo lë të kuptohet se Rektori Dema është mjaft i hapur në debat dhe me të mund të debatosh si me një shok. Këtë përshtypje mora atë ditë nga ai.

IF: *Qato kafe kush i pagujti wllaqko?*

VD: Kafet ishin nga shpija. Mbase ishim konak në Universitetin e Prishtinës, konkretisht në kampus, nënkuptohet që duhet të paguaj universiteti. Konkretisht këto kafe janë paguar me fondet për aktivitete të Rektoratit.

IF: *A kishte dëshirë axhi Marjan të kandidojë për rektor përsëri?*

VD: Së pari, ju kisha lutë që Rektorit Dema t'i drejtoheni me 'Rektor', 'Zotri Rektor', 'Zotri Dema' apo më së miri 'Zotri Rektor Dema'. E sa i përket pyetjes, mund të them se Rektori ndihej mjaft mirë. Ne e njohim atë si njeri ambicioz dhe të etur për të punuar për të mirë e studentëve, gjë që e ka dëshmuar shumë moti.


IF: *Prej 1- 10 sa e don rektorin?*

VD: Dashuria ime ndaj Rektorit nuk mund të matet me numra apo të përshkruhet me shkronja.

Pasi që e pamë që rektori po pin kafe me studenta, thamë pse jo edhe na? Pse çka kem na që s'mundem?

Ftojmë studentat e UP-së të aplikojnë për kafe me ORCA-n. Të dhënat e mëdjathtëshme i dërgoni në: gazeta.orca@gmail.com.

1. Emri dhe mbiemri:
2. Fakulteti - departamenti:
3. Viti i studimeve:
4. Çfarë kafe e pini?*
   - ☐ Espresso t'gjatë
   - ☐ Espresso t'shkurtë
   - ☐ Espresso 70-she
   - ☐ Espresso deri n'gjysë
   - ☐ Expreso
   - ☐ Espresso me qumësht t'ftohtë anash
   - ☐ Makiato t'madhe
   - ☐ Makiato t'vogel
   - ☐ Pa plum
   - ☐ Amerikane
   - ☐ Nescafe
   - ☐ Ness vanillë
   - ☐ Ness çokolladë
   - ☐ Kapuçino
   - ☐ Kafe turke t'idhtë
   - ☐ Kafe turke t'mesme
   - ☐ Kafe turke t'ombël
   - ☐ "Shef, a bon 1 gotë ujë"
5. Çka prisni nga ky takim?



Lyra Hoxha

Universitetet që operojnë si biznese

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, është një institucion transparent që merret me regjistrimin e shoqërive tregtare në Kosove a.k.a bizneseve. Kjo aNgjenci që hyn si departament i veçantë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, synon lehtësimin e procedurave administrative të regjistrimit të biznesit dhe përmirësimin e ambientit, ku veprojnë bizneset në Kosovë.

Nga ARBK, ofrohet mundësia e regjistrimit të një biznesi në mënyrë elektronike, si dhe qasja në të dhënat e bizneseve në fjalë. Mund të kuptohet më shumë në lidhje me: emrin e biznesit, emrin tregtar, komunën, datën e regjistimit, personat e autorizuar, kapitalin, numrin e njësive, aktivitetet primare e sekondare, etj.

Në anën tjetër, kur bëhet fjalë për kërkimin e shoqërive të caktuara, listimi i tyre është bërë në më shumë se 50 kategori të ndryshme, ndër to dhe arsimi i lartë.

Në këtë kategori, paraqiten të listuara universitetet private dhe biznese të tjera që operojnë (tërthorazi) në fushën e arsimit të lartë. Sidoqoftë, në vijim do të dokumentojmë disa raste specifike të këtyre shoqërive:

Universiteti i Prizrenit VS Universiteti i Prizrenit SH.P.K.

Përderisa në faqen zyrtare të Universitetit të Prizrenit tregohet se ky universitet filloi punën në vitin 2010 dhe se gjendet në rrugën "Shkronjat", po të njëjtat të dhëna nuk gjenden në faqen e ARBK-së (ndonëse është institucion publik). Në fakt, dëshmohet për ekzistimin dhe punën e Universitetit të Prizrenit SH.P.K., pra të një shoqërie tregtare që funksionon nga viti 2006 dhe në të cilën janë të punësuar vetëm 15 puntorë.

P.S. ky universitet çuditërisht gjendet në Kleçkë, në rrethinën e Prizrenit.

Ramiz Kelmendi B.I

B.I qëndron për Biznes Individual, në këtë rast i veprimtarit Ramiz Kelmendit. Jo i themeluesit të ELKOS-it, por i të ndjerit Ramiz Kelmendit, gazetarit dhe ish-kryeredaktorit te Redaksisë së Botimeve në ndërmarrjen botuese "Rilindja". Sidoqoftë, emri tregtar i tiji është Fakulteti i gazetarisë "Faik Konica", i cili është mbyllur në 2007, por akoma është i regjistruar si një bizneses jo i shuar.

Kolegji Universi SH.P.K.

Kolegji Universi gjendet në Bardhosh të Prishtinës dhe është një nga njësitë e Euro Sporti Group, SH.P.K. Në të ofrohen vetëm dy drejtime të studimeve në nivelin bachelor: Infermieri e Përgjithshme dhe Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion me një staf akademik prej 20 profesorësh.

"Stafi akademik i Kolegjit Universi është 100% me kualifikime adekuate dhe me përvojën e nevojshme në arsim, kjo dëshmohet përmes CV-ve tyre, ku krahas kompetencave profesionale ka edhe një numër modest të publikimeve shkencore në revista, kryesisht ndërkombëtare". Përndryshe ndër aktivitetet e këtij kolegji privat janë dhe: tregtia me shumicë jo e specializuar, tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara, transporti rrugor i mallrave, transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.

Sidoqoftë, neve s'na mbetet gjë tjetër, përpos se t'iu urojmë suksese edhe nxënësve të Gjimnazit Sportiv - Euro Sport (gjimnaz qe s'figuron në listën e gjimnazeve të komunës së Prishtinës, por është një nga njësitë e Eurosporti Group SH.P.K.) si dhe studentëve të "Universit" e Universitetit të Prizrenit (SH.P.K.).

Perla nga arsimi i lartë



Indrit Ferati

Perla nga CV-ja:

Hulumtuesit e ORCA-s pas hulumtimeve të CV-ve të punonjësve akademik, kanë qenë shumë afër orgazmave profesionale pasi ishin dëshmitarë të CV-ve të mega-profesorëve. Ne e kemi parë të arsyeshme që të provojmë t'iu "qefleisim" edhe juve, dashamirë.

AFTESISTE E KOMUNIKIMIT	Të folurit në mënyrë adekuate me një shumëllojshmëri të njrëzve, ndërsa duke mbajtur kontakt me sy, demondtrimi i një vokabulari të pasur dhe përshtatja e gjuhës me audiencën, dëgjimi në mënyrë efektive, tëshkruarit në mënyrë të qartë dhe koncize dhe të punuarit mire në grupe, përdorimi i mediumit të duhur, dhënja dhe marrja e feedbackut, etj.

Kjo CV ka të bëj me një profesor empirist, i cili i kushton rëndësi shumë shqisave. Disa studentë kishin dyshuar se profesori në fjalë po luan me hile, pasi mendonin se kishte instaluar 'qicën e wallhackut', ku i shikonte studentët përmes mureve se mos po flisnin pas shpinës keq për të.

SHKATHTËSI TË TJERA — Prirje për art dhe sport

Ky profesor kur kishte pasur intervistën me komision për të hyrë në punë, kishte ardh me fanelën e Ballackut me numër 13 dhe një top nërsjetëll. Komisioni ishte mahnitur se sa shumë kishte njohuri për finta. Njëri nga pjestarët e komisionit nuk ishte pro që ai të ishte pjesë e Universitetit, pasi në intervistë e kishte koritë duke i'a futur topin midis këmbëve... por kjo nuk ishte e gjitha. Pasi kishte bërë matjet me top ulur, ai morri lëpirësen dhe e futi në gojë. Pas afërsisht 6 minutave dhe 40 sekondave ai nxorri lëpirësen të cilën e kishte shëndrruar në portretin e rektorit me gjuhën e tij.

- Mësimdhënie, Dizajnim i programeve dhe syllabuese, realizimi dhe vlerësimi i tyre me metoda më të avanciuara, punë shkencore dhe kërkokimore, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare

Dizajnim I syllabuseve për mësimdhënie dhe implemetim I tyre me metoda më të avancualara të mësimdhënies, angazhim intelektual dhe pedagogjik.

Ky shkrim jep përshtypjen e parë se është i llojit "m'falni se 1 fmi i vogel e ka shkru", por jo. Këtu kemi të bëjmë fjalë me një profesor i cili ka shënuar CV-në e tij në pikën kulminante të zhegut. Ne si redaksi apelojmë që profesorët të strehohen verës nga ora 11:00 - 16:00, në atë mënyrë që të rritet cilësia në arsim.

Publikimet tjera

	Titulli	*Libri*	*Titulli*
1.	D.Hoti, S.Kacapor, E. E.Growing: Mozaik – A multicultural and bilingual approach to preschool education, Manual for Educators and Parents,	"Save the children" / Gjuha: Anglisht	2008, p. 120 Prishtinë
2.	D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – pristup decijem predskolkom multikulturnom i dvojezicnom obrazovanju, Prirucnik za vaspitace I roditelje,	"Save the children" / Gjuha: Serbe	2008, p. 120 Prishtinë
4.	D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – pristup decijem predskolkom multikulturnom i dvojezicnom obrazovanju, Prirucnik za vaspitace I roditelje,	"Save the children" / Gjuha: Boshnjake	2008, p. 120 Prishtinë
3.	D.Hoti, S.Kacapor, E. Growing: Mozaik – Okul çok kultulu ve iki dilde çocuk egitimine yaklasim, Egimen ve ebeveynlere Yonik el kitabi,	"Save the children" / Gjuha: Turke	2008, p. 120 Prishtinë

Tempulli i Dijes ka angazhuar një agjent që të përfshihet në grupin e mbyllur të profesorëve në viber "Kërrk integriteti akademik". Aty ka pasur tutoriala të ndryshëm, si p.sh "5 mënyrat më të lehta për t'u bërë profesor". Njëra nga to ishte kjo foto, ku një punim shkencor (n'fakt raport OJQ-sh) e përkthen në gjuhë të ndryshme dhe i bën katër. Autorin e këtyre gjetjeve kreative e ftojmë që të rekrutohet në SHIK si 'Mbikqyrës i Dallavergjive'.

Perla tjera:



Për studentët që kanë dilema, google është destinacioni i duhur. Nëse edhe aty e keni nafakën që nuk gjeni përgjigje adekuate, Tempulli i Dijes është i përbërë nga:
1. Urolog
2. IT
3. Këshilltarë për studime.
Mirë se vini!

Redaksia ka rënë pre e provokimeve të armiqëve tonë nga njëri prej ishujve të Skenderajit. Nëse ju mendoni se ne e kemi të lehtë...ne nuk e kemi. Agjenti jonë i cili ka rënë pre e këtij provokimi, ka qenë shumë afër pranimit të ofertës, pasi i ka mbetur vetëm një provim në lëndën e një profesori që ka inat ndaj tij pasi nuk ka pranuar që t'ia blejë librin e tij.

Sot gjatë terminit të zhvilluar në mes profesorëve dhe ne studentëve të Shkencës Politike(viti II-të), profesorët arritën që të na njoftojnë me humbjen e parë dhe kështu ata e thyen hegjemoninë e vendosur nga politologët.

Në stadiumin "Magazica" u mbajt turniri akademik "Platoni shënon". Studentët pas humbjes ishin arsyetuar se i kishte kapluar "msyshi". Redaksia e TD kishte dëgjuar se kur kapiteni i perfaqësueses së Universitetit për termina kishte ligjëruar lëndën e tij zgjedhore "Aplikimi i politikës në futboll", UP nuk ka pasur buxhet që të blihen topa "katërsh" të terminëve. Kështu njëri nga studentët kishte marr iniciativën që t'a marr topin gjysëm-origjinal që ia kishte sjellë daja nga Bullgaria. Inati dhe xhelozia mes studentëve tjetër që ndjekin lëndën "Aplikimi i politikës në volejboll", ka shtyrë që subjektet në fjalë ta çfryejnë topin e termineve para turnirit. Profesori i lëndës nuk e kishte të vështirë të shënonte gola, pasi temën e diplomës e ka mbrojtur me top fallc. Shpresojmë që këta student kur të bëhen politikan, ta ndryshojnë projektligjin për buxhetin e topave në Universitet dhe Kosova të ketë një të ardhme që e meriton.

shporta e studentit



Adea Kondirolli, Dibran Hoxha, Sara Sylejmani

70,313 STUDENTË

55.4% TË PAPUNË

25 EURO PËR SEMESTËR + 37.7 EURO MESATARISHT PËR LITERATURË

Hyrje

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 70,313 studentë janë pjesë e sistemit universitar publik, megjithëse vetëm 55.4% e të rinjëve janë të papunë.

"Sa rrinë badihava ma mirë shko në shkollë", thotë një fjalë e urtë popullore. Ose, "më mirë bujk e me fakultet sesa bujk analfabet". Pritshmëritë e larta shoqërore për shkollimin e gjeneratave të reja kanë ndikuar që Kosova të konsiderohet si vatër e elitës intelektuale.

Pavarësisht çmimit të ulët të pagesës së semestrit, familjet kosovare kanë vështirësi në shkollimin universitar të fëmijëve të tyre. Paga mesatare në Kosovë për vitin 2017 është 471 euro neto dhe rrjedhimisht familjet hasin në vështirësi për ti mbuluar poashtu edhe shpenzimet e vizave dhe pagesave të tjera për programe "Exchange" janë vendit. Prandaj, ORCA ka vendosur të hulumtojë sa shpenzon një student në Universitetin e Prishtinës, në mënyrë që të kuptojmë natyrën e shpenzimeve, dhe çka mund t'i ofrojnë institucionet këtyre studentëve.

Të Dhënat e Përgjithshme

Universiteti i Prishtinës ngarkon studentët të paguajnë 25 euro për semestër, kurse viti i parë është falas. Kjo dukuri nuk aplikohet edhe për shtetasit e huaj pasiqë me këtë rast Kosova rrezikohet nga imigrimi legal.

Studentët në UP mesatarisht shpenzojnë 37.7 euro për semestër në literaturë gjatë studimit. Shumë herë ata janë vetë autorë të skriptave dhe materialeve të tjera mësimore mirëpo zakonisht me shumë dashamirësi ata mbështesin financiarisht profesorët duke i blerë librat e tyre.

"Studentët Lazdranë" konsiderohen ata të cilët ushqehen në mënyrë vetanake duke shpenzuar mesatarisht nga 5 euro në ditë. Kjo kategori e UP-së ankohen se mensa e studentëve nuk ofron ushqime të shijshme dhe se ushqimi në Qendrën e Studentëve nuk ka variatet.

Shpenzimet totale mujore për studentët e Universitetit të Prishtinës variojnë nga 25 (ja'u qafshim hallin) deri në 400 euro, ku përgjigjja më e shpeshtë është 150 euro. Shpenzimet e studimeve kryesisht mbulohen nga familja, pasiqë tregu i punës në Kosovë nuk është i hapur për të rinjtë.

Shpenzimet totale mujore:

përgjigja më e shpeshtë

25 euro — **150 euro** — **400 euro**



TEMPULLI I DIJES • KORRIK 2019, NUMRI 05

SHPORTA E STUDENTIT

Të Dhënat Specifike — (Sponzorët e UP-së)

Fakulteti Ekonomik

Ata që mendojnë se studentët e Fakultetit Ekonomik shpenzojnë 22.36 euro në semestër për literaturë me qëllim të iluminimit të tyre intelektual e kanë gabim! Studentët shpenzojnë para për të blerë librat origjinal të profesorëve në mënyrë që të solidarizohen me ta. Është i papranueshëm fakti që një profesor i rregullt të siguroj jetesën e familjes së tij vetëm nga rroga bazë prej 1429 euro në muaj, andaj kontributi i studentëve është tejet i rëndësishëm. Megjithatë, studentët kanë shprehur revoltën e tyre sepse profesorët kanë vendosur të mos i shërbejnë me kafe e llokum studentët gjatë ceremonisë së blerjes së librave në kabinetet e tyre përkatëse.

Si shpenzim shtesë në këtë fakultet është theksuar mbajtja shtesë e kurseve me qëllim zotërimin e lëndës, fenomen ky që pavarësisht efekteve pozitive në ngritjen profesionale të studentëve, ka ngjallë konflikte t'ashpra mes atyne që i mbajnë kto kurse.

22.36

+kurset

+350 euro për ngritje profesionale

Fakulteti Juridik

43.9

Akoma më të irituar vërehen të jenë studentët e Fakultetit Juridik, të cilët shpenzojnë 43.9 euro në semestër për literaturë. Zemër-gjerësia e këtyre studentëve përsëritet në kontinuitet. Sa herë që profesorët i "përditësojnë" librat e tyre, studentët pa hezitim ju drejtohen kabineteve dhe me këmbëngulje blejnë versionet e azhurnuara të librave. Kurse profesorët edhe atëherë nuk gjejnë kohë për ti gostisur ata.

Sikur kjo të mos mjaftonte, studentët e kësaj njësie akademike përgjatë studimeve duhet me gjet naj avokat me pagu për me u ngrit gjoja profesionalisht. E kjo shumë zakonisht shkon deri në 350 euro. (Është evidentu se ni zyrë e avokaturës ka ofertë të pa rezistueshme, paguaj kurs avokature, merr kurs boksi falas)

Fakulteti i Edukimit

Ndërsa studentët e Fakultetit të Edukimit, këtë aktivitet solidar e marrim me sportivitet. Ndonëse ata kontribojnë në mirëqenien e profesorëve me 24.3 euro në semestër për blerjen e materialeve përgatitore për provime, studentët e këtij fakulteti e shohin si demode faktin që profesorët nuk i aplikojnë vlerat e të parëve siç predikohet me traditë. Gjithashtu, mësonjësit tonë t'ardhshëm duhet me i pagu shpenzimet që lidhen me praktikat që duhet me i kry në shkolla.

24.3



88 +47.2 euro për gjësende rrethanore (si bretkosa)

Fakulteti i Mjekësisë

Përceptimet e studentëve ndaj fenomenit të "sponzorizimit" variojnë nga njëri fakultet në tjetrin. Të dhënat e hulumtimit të ORCA-s tregojnë se studentët e Fakultetit të Mjekësisë ndonëse kontribojnë financiarisht çdo semestër me një shumë mesatarisht prej 88 euro, që njëherit është ndër më të lartat nga të gjitha njësitë akademike të UP-së, ata vazhdojnë të jenë të kënaqur me zemërgjerësinë e tyre. Sipas pjesëtarëve të këtij komuniteti, profesorët duhet mbështetur me blerjen e librave të tyre në mënyrë që ata të mos obligohen të shkojnë në Gjermani për të punuar për një rrogë më të lartë. Andaj, sponzorizimi i profesorëve të mjekësisë është obligim nacional dhe blerja e librave të tyre është akt patriotik.

Edhe nja 47.2 euro për semestër duhet me ble gjësende rrethanore për studime, kto baziket: mantele, veshje adekuate, kapuça, dorëza deri bretkosa. E për kto të fundit fakulteti pritet me nënshkru ni memorandum bashkëpunimi me një fabrikë të që merret me kultivimin e bretkosave.

Fakulteti Filozofik

Studentët e Fakultetit Filozofik të cilët reflektojnë me shumë maturi karshi traditës së mikëpritjes Kosovare. Studentët argumentojnë duke thënë se kombi Kosovar është artificial dhe i imponuar nga ndërkombëtarët, andaj nuk është relevant fakti që profesorët janë të pa bindur ndaj normave shoqërore. Ngjashëm si kolegët e tyre, studentët e Filozofikut janë stoik ndaj bindjeve të tyre dhe me shumë vendosshmëri do të vazhdojnë të paguajnë nga 24.46 euro për literaturë në semestër. Kurse sa i përket shpenzimeve të materialeve shpenzuese për hulumtime, prezentime, dhe punime seminarike, studentët thonë se 17.5 euro në semestër është shumë e papranueshme, pasiqë me këtë rast profesorët nuk janë përfituesit e drejtpërdrejt.

24.46

43 +133.21 euro për brusha, ngjyra e qisi...

Fakulteti i Arteve

Të shtyrë poashtu nga ndjenja patriotike, studentët e Fakultetit të Arteve thonë se shpenzimet për literaturë në vlerë të 43 euro në semestër janë investime afatgjata në shoqërinë kulturo-artistike të Kosovës. Ata janë të bindur se me investime të tilla, profesorët do të jenë më të motivuar që të krijojnë vepra artistike të cilat do të përmirësojnë imazhin e vendit në arenën ndërkombëtare.

Kurse shpenzimet e tjera për blerjen e brushave, ngjyrave e shumëçka tjetër në vlerë prej 133.21 euro në semestër, janë shpenzime të rëndomta të një artisti kredibil. Arti në vete është disiplinë me peshë që përmes veprave artistike, autorët flasin dhe bëjnë ndryshime rrënjësore në shoqëri. Kështuqë çdo shpenzim ekstra është i justifikueshëm dhe studentët kanë privilegjin ti ndjekin mësimet në këtë fakultet.

Fakulteti i Filologjisë

Një fenomen interesant është vërejtur tek profesorët e Fakultetit të Filologjisë të cilët në mënyrë demostrative i sigurojnë studentëve literaturë online në formatin PDF, megjithëse studentët prap se prap obligohen të blejnë libra në vlerë prej 36 euro në semestër.

36



49 +100 euro për vizore, hamera e softwera

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Një e gjetur interesant është vërejtur tek studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Solidariteti i tyre arrinë në piedestal kur studentët deklarohen vullnetarisht se janë të privilegjuar të blejnë një libër në gjuhën serbe, ndonëse nuk kanë njohuri bazike të kësaj gjuhe. Për më tepër, ata janë të lumtur se profesorët i nxisin që të sigurojnë literaturë nga interneti dhe skriptat e shumta që shpesh-herë përgatiten nga vetë studentët, relevanca e të cilave është impresionuese. Ndonëse shkrimi i librave nga profesorët në këtë fakultet nuk aplikohen në çdo lëndë, studentët sërish janë të kënaqur që sponzorizojnë profesorët e tyre mesatarisht me 49 euro për semestër.

Shpenzimet tjera të cilat studentët i kanë deklaruar pa pikë turpi janë do pajisje speciale për punime: çanta të posaçme, vizore, hamera, stilolapsa adekuat, e kështu me radhë, që mund të mbërrijnë vlerën e 100 eurove (çka janë 100 euro për marakli). Edhe do kurse që duhet mi mbajt për disa programe softwerike të cilat nuk i ofron fakulteti, por, këto njohuri kërkohen në provime.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Një shembull tjetër tipik i kopracisë është ai i studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të cilët aspak nuk janë mirënjohës ndaj një pjese të profesorëve të cilët ju ofrojnë literaturë në sistemin elektronik të studentëve (SEMS). Kurse shpenzimet për literaturë i kanë mesatarisht 35.20 euro në semestër. Protestojnë me të padrejtë ndaj një profesori që obligon ata të blejnë në kabinetin e tij një libër në vlerë 10 euro dhe një tjetri që obligon studentët të blejnë 5 libra në vlerë prej 20 euro.

Studentët e FIEK do të duhej të quheshin si studentët e FIKTË. Si të paturp që janë ata shpenzojnë vetëm 25.71 euro për literaturë dhe kategorikisht refuzojnë të solidarizohen me profesorët e tyre. Kryesisht materialet akademike i sigurojnë nga librat e fotokopjuar dhe skriptat e ndryshme. Mesatarisht, studentët e FIEK shpenzojnë 51.65 euro në semestër për materiale shtesë. Edhe kta do shpenzime palidhje si: mikroprocesorë, module për ushtrime, kalkulatorë, fleta të bardha për ushtrime, kurse shtesë për zotërimin e lëndës edhe pse këtë të fundit nuk je i detyruar, porse lënda kalohet më lehtë nëse ndjek kurset shtesë për lëndë të caktuara.

FIEK dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore

35.2

25.71

+51.65 për materiale shtesë

32

Kurse studentët e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore janë plotësisht të panjoftuar me format alternative të literaturës. Ata refuzojnë që të bien në kontakt me librat online pasiqë kanë ndëgjuar se paraqesin probleme me shqisën e të pamurit dhe prekurit. Prandaj luftimi i këtyre anomalive shëndetësore duhet bërë duke tharë lekun prej 32 eurove për blerjen e librave origjinal të profesorëve, citohet të kenë pjesa dërmuese e studentëve.

Fakulteti i Bujqësisë

Studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë shpenzojnë mesatarisht 25.38 euro në semestër për literaturë. Kryesisht e bëjnë këtë që profesorët ti favorizojnë ata duke i shpërblyer me pikë shtesë në provim. Dhe si kopracë që janë, studentët e FBV njihen edhe si interesgji të mëdhenj, prandaj nuk bëhet fjalë për solidarizim me profesorët e tyre varfanjak.

Materiale shpenzuese si xhama për mikroskop, mantele për brenda fakultetit dhe në terren, çizme, stetoskop, që të gjitha duhet t'i mbulojnë vetë studentët. Këto shpenzime arrijnë 45 euro në semestër mesatarisht. Ekuivalenti i bretkosave në Fakultetin e Mjekësisë është pula në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. (p.s studentët kanë deklaru se pas eksperimenteve me pulën, atyne nuk u lejohet me marr me pjek te shpia, edhe pse e kanë pagu vet).



25.38

+45 euro për materiale shtesë dhe pula

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportiv






19 +105 euro termine e ushtrime

Thonë se sporti me literaturën janë rryma të ndryshme, andaj edhe profesorët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportiv e kanë kuptuar këtë çështje me kohë dhe nuk i obligojnë studentët të blejnë librat e tyre. Studentët e FEFS shpenzojnë vetëm 19 euro në semestër për literaturë.

Shumë disiplina në sport, shumë pare t shpenzume. Studentët e FEFS-it kanë shpenzime shtesë që lidhen me sigurimin e pajisjeve të ndryshme sportive të tilla si: rroba të veçanta për disiplina (shembull: futboll, karate, not etj.) Pastaj aplikimi i sporteve në praktikë përmes shfrytëzimit të pishinave, ambienteve të ndryshme sportive (palestra, pista të atletikës), terrene për skijim etj. Edhe pse zakonisht kur këto aktivitet organizohen nga fakulteti ka lehtësime në pagesa për studentë (na keni nihmu...). Krejt kto shpenzime arrijnë 105 euro në semestër, mesatarisht.

FAQE 8

FAQE 9

udhëtime	qiraja	ushqimi	totale
			
Fakulteti i Arteve	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Fakulteti i Arkitekturës
14.80	122	6.66	200
euro në javë	euro në muaj	euro në ditë	euro në muaj
4.55	58	2.81	109
Fakulteti Ekonomik	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
			

Përfundime

Megjithëse shpenzimet e studentëve të UP-së gjatë studimeve numërohen relativisht të larta, studentët nuk shpehin shqetësime të shumta, madje ata janë të kënaqur që shërbejnë si shtyllë elementare për mirëqenien e profesorëve. Gjatë diskutimeve në fokus grupe, është potencuar se në ShBA mesatarisht një student shpenzon $1200 në vit (libra & materiale të tjera shpenzuese), andaj krahasuar me këtë vlerë monetare, studentët e UP-së rangohen në një pozitë jashtëzakonisht të lakmueshme. Për më tepër, kushtet e këqija në konvikte nuk paraqesin ndonjë problem serioz duke marrë parasysh faktin që studentët i kalojnë në këto hapësira vetëm disa orë gjumë në ditë.

Sa i përket cilësisë së ushqimit në menzë, studentët ankohen me të drejtë. Me raste ndodhë që pireja të ofrohet me jahni pa mijane, aspekt ky që paraqet probleme serioze tek studentët që kanë alergji në gluten. Si pasojë, studentët janë të detyruar të konsumojnë ushqime të tjera alternative në mënyrë vetanake, ku për tre shujta në ditë nuk shpenzojnë më shumë se 4.7 euro.

Sipas të dhënave të hulumtimit, kryesisht del se studentët që më së shumti shpenzojnë para në udhëtime janë studentët e Fakultetit të Arteve, (14.8 euro në javë). Ky fenomen në rrafshin popullor shprehet si; "edhe artist edhe fshatar se rrok". Kurse studentët e Fakultetit Ekonomik janë ata që më së paku shpenzojnë për udhëtime (4.55 euro në javë). Përpos që njihen si kursimtarë të mëdhenj, studentët e këtij fakulteti konsiderohen si qytetar tejet të integruar në kryeqytet.

Sa i përket qirasë, studentët e Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore shpenzojnë më së shumti (122 euro në muaj) kurse ata të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike shpenzojnë më së paku (58.33 euro në muaj), "sa ma ngushtë, aq ma gjonë" citohen të kenë thënë studentët e FIM. Për më tepër, ndarja e hapësirave banuese me kolegë praktikohet edhe në vendet e civilizuara të perëndimit, andaj studentët e këtij fakulteti preferojnë të jenë një hap me kohën.

Kur bëhet fjalë për shpenzimet e ushqimit, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike janë ata që prijnë në Universitet duke shpenzuar 6.66 euro në ditë, ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku, vetëm 2.81 euro në ditë. Ushqehen kryesisht me tosta te "VIZIT" dhe energji të diellit, me qëllim që të promovojnë vlerat ekologjike. Çfarë do që vjen prej Zotit është e mirëseardhur, prandaj edhe rrezet e diellit gëzojnë respekt të veçantë tek kjo kategori e studentëve.

Sa i përket shpenzimeve totale mujore, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës shpenzojnë më së shumti (200.38 euro në muaj), këto shpenzime kryesisht alokohen për aktivitete rekreative si tenis, polo, dhe golf. Ndërkohë që studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike shpenzojnë më së paku (109.61 euro në muaj).

Për pak me i harru bursat, kto universitare që zakonisht dalin n'llogari studentëve gjatë pushimeve verore, e kto te Ministrisë së Arsimit që ndahen sipas parimit "ku t'qëllon" për do fakultet po, për do fakultet jo. Hajgare, se ministria ka "plan strategjik afatgjat" (tri rrena ni fjali).

KRONIKA E ZEZË



Basri Oruqaj

Zoge Hasani

"SUPERMENËT" SPECIE NE ZHDUKJE

ORCA vitin e kaluar ka denoncu 8 profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të cilët janë avancu në titullin e profesorit të rregullt, titullin ma t'lartë akademik në vendin tonë.

ORCA pati argumentu se punimet që janë marrë parasysh për avancimin e tyre nuk janë të publikume në revista kredibile pasi të 8 profesorët kishin publiku nga 7 deri në 19 punime brenda nji periudhe 1 vjeçare e gjysmë.

Më 6 korrik 2018 ORCA si gjithë tu mos i lan rahat supermenat, ka zhvilluar komunikimin e parë me SCOPUS ku ka paraqit dyshimet për revistat në të cilat kanë publiku supermenat, duke dërguar analizën e bërë edhe me ndihmën e ekspertit Beall.

Më 23 korrik 2018, Senati avancon 8 profesorët e rregullt të denoncuar nga ORCA. Ndërsa më 13 gusht 2018 SCOPUS njofton ORCA-n se revistat zyrtarisht dhe formalisht janë futur në rivlerësim.

Për me jau hjek ngjyrën supermenave, platforma SCOPUS më 23 prill 2019 e njofton ORCA-n se revistat nuk janë më pjesë e indeksimit për vitin 2019 e tutje.

Vlerësimi i Scopus për marrjen e vendimit për t'i hequr nga lista për vitin 2019 këto dy revista shkencore është mbështetur në vlerësimin për veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2017/2018, kur edhe kanë publikuar e kur janë avancuar 8 profesorët e FIM.

Tash prej krejt ksaj pe dim qe 8 profesorët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike janë avancu në mënyrë jomeritore në titullin profesor të rregullt me çka kanë fitu kontratë të përhershme.

Po doket që hera e fundit që po shkrujmë për Supermenat e FIM.

SUPERMENAT

Hajgare bonem, se s'kem mu ndal kurrë ty shkrujt për Supermena, poget. Në 1 hulumtim t'lehtë të deklarimeve të pasunisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, ku i kanë deklaru të ardhunat e tyne stafi në pozita drejtuese/menaxhuese në universitete publike, hasëm në supermenat tonë të dashtun.

N'fillim kur kena hulumtu për ta, jena brengosë që kanë publiku qaq shumë punime në revista mashtruse (që t'marrin pare për me publiku); mendojshim që supermenat tonë kanë mbet pa pare, po jo.

Kryesupermeni, dekani Ahmet Shala, ka deklaru në AKK që nga Universiteti i Prishtinës i ka marrë 40,414.09 euro në vitin 2018 (neto)[1]. Të konvertume në pagë mujore, kjo shumë del 3367 euro në muj. Kjo pagë mujore është më e madhe se e vet rektorit, e të gjithë profesorëve të tjerë. Kjo pagë është po ashtu më e madhe se e Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

Ndoshta duhet me na bo një trajnim supermenat bashkë me Loredanën, për qysh me bo pare.

1 https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Deklarimi%20i%20Pasurise/Deklarimet/declaration/2019/Qeveria/Ministria%20e%20Arsimit%2C%20Shkenc%C3%ABs%20dhe%20Teknologjis%C3%AB/Ahmet%20Shala.pdf

Kosova dhe Shqipëria përveç tjerash kane te përbashkët edhe paaftësinë për të bërë shkencë të mirëfilltë.

Një studim i bërë nga "Nature"[1] (International journal of science) dëshmon se Kosova dhe Shqipëria qëndrojnë më së dobëti në rajon sa i përket publikimit të punimeve shkencore.

Referuar të gjeturave të kësaj reviste rezulton se Shqipëria ka më pak se një publikim shkencor për dhjetëmijë banor, Kosova qëndron pak më mirë, por, jo me ndonjë dallim signifikant, sepse krahasuar me rajonin Mali i Zi ka sa dyfishi i Kosovës, ose pak ma shumë se Shqipëria e Kosova bashkë, e mos të flasim për Islandën e cila me 300 mijë banorë, ka 10-fishin e Kosovës.

Kjo paraqet më së miri dështimin tonë për të bërë shkencë, natyrisht që kjo paraqet deformimin e sistemit të arsimit që na ka përcjellë me vite, korrupsioni, nepotizmi, jo profesionalizmi, mungesa e meritokracisë, drejtësisë e barazisë, padyshim që shkaktojnë gjendjen që jemi sot në fushën shkencore dhe jo vetëm.

1 https://www.nature.com/articles/d41586-019-01565-0

Rexhep Maqedonci: "Studentët që ankohen për ngacmim seksual janë të poshtër"

Prokurori Rexhep Maqedonci në deklaratën e tij të publikume me datën 25 mars 2019 në Kallxo.com, akuzon ashpër studenten e cila paditi profesorin Milaim Sejdini për ngacmim seksual, ai tha se "këta student janë të poshtër".

Prokurori Rexhep Maqedonci, në vend se të inicoj hetime të pavarura dhe objektive në rastin e raportimit të ngacmimit seksual, ka vendos me fajësu viktimën, duke ndiku kështu direkt në mbarëvajtjen e hetimit si dhe duke u mundu me frikësu e shantazhu viktimën e ngacmimit seksual.

Marrë parasysh ecurinë e këtij rasti shoqëria civile përmes nje letre ka kërku shkarkimin e këtij prokurori nga rasti në fjalë për arsye të anshmërisë me palën e akuzuar dhe trajtimit jo të denjë të viktimës në fjalë. Paragjykimet e prokurorit në fjalë e privojnë nga kërkimi i drejtësisë secilën viktimë të ngacmimit seksual ndërsa inkurajon ngacmuesit e tjerë potencial, të vazhdojnë me ngacmimet e tyre.



Pas krejt këtij presioni publik Prokurori Rexhep Maqedonci u largu nga hetimi i rastit.

Kampusi universitar, Univers i PDK-së

Në një tubim të PDK-së në kampusin Universitar në Prishtinë, Kadri Veseli kryetar i kësaj partie ka zyrtarizu kandidaturën e Uran Ismajlit për kryetar të Prishtinës.

"Nuk kam parë njeri që e dëshiron më shumë qytetin e vet se Uran Ismaili. Urani e do Prishtinën me zemër..." kishte thënë Kadri Veseli në tubim. Por, ka edhe diçka që kjo parti e do me më shumë zemër, Universitetin e Prishtinës (nëse keni dilema për këtë shihni numrin e kaluar të Tempullit të Dijes fq.10).

Ne e kemi parasysh që krerët e PDK-së janë vazhdimisht t'etur për dije, veçse i lusim që përmbushjen e këtij qëllimi ta realizojnë nga distanca, e jo duke qëndru fizikisht në hapësirat universitare.

Përveç kësaj, këtu është edhe nji problem tjetër, kush ua ka dhënë lejen për shfrytëzim të kësaj hapësire, personave të cilët realizojnë fiskulltura partiake aty? Ne e lusim Universitetin që para se t'i jap lejet për shfrytëzim të hapësirave universitare, t'i shqyrtojë mirë dobitë që kishin mujt me i sjellë këto aktivitete Universitetit dhe shoqërisë.

Deri në tubimin tjetër, shnet...

Aps universitetet Kus Si? Pse



Etnik Jakupi

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës rreth 20.3 % e personave që kanë përfundu arsimin terciar (universitar) janë të papunë (ktu tu mos i llogarit ata që e kanë përfundu këtë nivel të shkollimit e që qesin makiato pa shkumë; shef, a bon ni gotë ujë), por, kjo shifër nuk i shqetëson absolventat tanë t'mrekullueshëm.

Të studjumit që ndryshe kish me u përkthy nji person që hulumton vazhdimisht për fushën e vet t'studimeve, studentave tonë hulumtimi i ka shërby veç në nji drejtim: me hulumtu për restorantin ma t'mirë, këngtarin ma t'mirë etj. Por, hulumtimi është vetëm hapi i parë drejt përsosjes intelektuale.

Pas hulumtimit, nxitet aftësia e të gjykimit dhe të mendumit në mënyrë kritike, studentët përmes përplasjeve dhe debateve të tyre intelektuale argumentojnë se cilin këngëtar duhet me zgjedh, çfarë shërbimi të ushqimit me marrë, transportin (krejt kto çka shkojnë me organizimin e absolventiadës).

Vlen me u cek që fakultetet me aftësi të thella kritike i zgjedhin këngëtarët ma t'mirë dhe ma shpejtë kuptohet (më poshtë i keni organizimet e fakulteteve dhe këngëtarët që i kanë përzgjedh per këtë mbramje t'pa harrushme)

Filozofiku: Vesa Luma & Korab Shaqiri
Juridiku: Hekuran Krasniqi & Egzon Pireci
Ekonomiku: Alban Mehmeti & band Baboo Darabuka
Artet : Korab Shaqiri & Vesa Luma, tupan show dhe dj
Tekniku: Korab Shaqiri & Sidorela Kelmendi, dj Nicky dhe Tarabuka show
Mjekësia: Afrim Muqiqi dhe Yjet, Alban Mehmeti dhe band, Baboo Tarabukat dhe dj Benity
Filologjia dhe FShMN: Sabri Fejzullahu dhe Nadi, pije pa kufi.

Çka kan bo?

Apsolventiadat e tyre ishin pak a shumë të ngjajshme, askush nuk rrezikoi me ndryshime drastike sa i përket atmosfer-bërësve, pra nejat u kallën në mënyra të ngjashme pasi edhe këngetarët ishin të përafërt.

Nga larmishmërit e mësipërme, ne si juri përzgjedhim Fakultetin e Arteve, ata si gjithnjë arrijnë të dallohen, dhe kësaj here ata u dalluan me tupana show, pra ata meritojnë respekt për ruajtjen e vlerave historike-kulturore.

Kurse, më të dobëtit ishin Filologjia dhe FShMN-ja, si duket dy fakultete nuk arritën të sillnin këngëtar sa mesatarja e përgjithshme dy për fakultet, ata si duket i dëshperuan studentet e tyre.

E kur po mahen ato?

Apsolventiadat e kanë ni të mirë që nuk organizohen afër afatit te qershorit, nuk dihet ende as nga burimet se përse e bëjnë këtë. Këtu qarkullon një hipotezë se nuk i organizojnë afër pasi që nuk duan t'i pengojnë për afatin e provimeve, dhe organizohen ni muaj para që studentët të motivohen për me mësu ma shumë.

E pse po mahen o babo?

Nuk e di pse mahen, po e di se për me festu duhet një arsye, të cilën studentët nuk e kanë.

A kish mujt mu bo mirë?

Ndryshimet në universitet do të ndodhnin nëse do kërkoheshin nga studentë të një grupi të unifikuar të cilët dëshirojnë cilësi më të lartë të studimeve në UP. Por, edhe pse ne kemi këto grupe të unifikuara ato nuk veprojnë për këtë çështje, pra kuptohet që "studentët" do të gjesh të unifikuar vetëm në një vend, madje është për tu mahnitur se si ata të gjithë bashkohen të harmonizuar në vallen 2 para 1 mrapa. është e vështirë të kuptosh pse njerëzit dëfrehen kur nuk ua gjen arsyen, dhe mendimi më logjik është dëfrehem me "hekë t'keqtin", pra gjasat janë që festimi është me e hek t'keqtin, dmth kelbin e hekat e fakultetit edhe mu shkapërderdh (videot e apsolventiadave në Youtube e dëshmojnë këtë) tu kcy.



"Fakulteti i Autoshkollës"

Lirim Isufi

"Qu ma shpejt se s'mundesh me mbrri për ligjërata" – ishte fjalia që ma prishi gjumin atë të premte. Duke fërkuar sytë u zgjova nga gjumi dhe e pashë se ora kishte kaluar 7-tën. Nxitimthi lava dhëmbët, u vesha dhe u nisa për të "thithur" dije.

Jashtë një petk i bardhë kishte mbuluar horizontin përreth dhe ishte mjaft acar. Rruga për në tempullin e dijes më ngjallte asi zjarri të madh në zemër, sa që digjesha nga entuziazmi, sikur Yll Limani nga dashuria. E si të mos ndihesha ashtu? Pas pak do të futesha në laboratorin 100 mijë dollarësh, kolegët dhe profesorët do të ishin duke pritur me buzëqeshje, puna do të zhvillohej në mënyrë kreative dhe të përbashkët, pa shkëputje… Haaa Ishalla se besut!

Ja se si rrodhi ngjarja me të vërtetë: Asistenti erdhi me vonesë si zakonisht, dukej shumëi mërzitur dhe nervozuar, shkruani emrat tha duke bërtitur dhe pastaj doli të fliste me dikënd në telefon. Pastaj erdhi asistentja e asistentit të profesorit me një çaj në dorë duke u ankuar "Dreqi e hangt, po herët po ja nismi bre dala ju plast"- duke buzëqeshur na tregoi ushtrimin që kishim për ta kryer dhe doli pastaj edhe ajo. Normale që ne sikur studentë të zellshëm dhe puntorë që jemi, bëmë atë që çdo student tjetër me ambicie të larta do të bënte, morëm çantat dhe u nisëm për fotokopjen përballë për të blerë testet për tu përgatitur për provimin që e kishim nesër.

Tashmë ishte shumë demode të mësojmë me libra apo skripta, kur mund të kursenim kohë për kafe dhe festa me shoqëri duke i mësuar vetëm testet e fotokopjeve, sepse profesorët nuk i ndërronin asnjëherë pyetjet. S'u kan budall Makiavelli – tha një koleg që e urrente filozofinë!

Dhe cikli i njëjtë vazhdonte çdo ditë. Edhe koha e praktikës ishte vatra e dijes. Aty më shumë mësonim të analizonim vajzat e djemtë e fakulteteve private, të cilët si për çudi defilonin nëpër korridoret e spitalit sikur nëpër pasarela të modës. Të zihej fryma nga të nxehtit, era djersë kundërmonte gjithandej, zhurma, qeshje, biseda, fotografitë e rrjetet sociale ishin gjithçka çka bënim, sepse asistenti vonohej 40 minuta çdo herë me arsyetimin se e kam pasur një operacion të rëndë dhe pastaj vazhdonte ta rrëfente sikur ndonjë dramë turke duke heroizuar veten sa herë që shpëtonte një pacient e duke e lënë në dorë të Zotit sa herë që e humbiste ndonjë.

Numri i madh i studentëve, mungesa e laboratoreve, numri i vogël i bibliotekave (fakt interesant: një kolege, zgjohet në ora 6 për të arritur në bibliotekë në ora 7, e për të pritur pastaj deri në 8 kur edhe hapet biblioteka, në mënyrë që ta zë një vend për tu ulur!), kushtet jo të mira laboratorike, hapësirat e vogla, mungesa e mjeteve teknike për prezantime (fakt Interesant 2: një profesoreshë ankohej duke thënë se "prej klinikës deri në dekanat po vi tu ra shahadet për me bo projektori sot, e ju po boni zhurmë" Pilifuncat e dreqit!) janë vetëm disa nga 10 faktorë që e pamundësojnë rritjen e numrit të studentëve në fakultetin e mjekësisë. Por, krejt kto fakte nuk i ndalojnë institucionet, rrjedhimisht ministrat tonë me fantazu.

Në nji takim mes ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Shyqiri Bytyqi dhe ministrit të Shëndëtësisë Uran Ismajli u diskutu mundësia që në vitin akademik 2019/2020 me u rrit numri i studentëve në Fakultetin e Mjekësisë.

Një rritje e tillë do të shkaktonte kaos institucional, me rritjen e numrit të studentëve nëpër ligjerata, rritjen e numrit të studentëve në praktikë, mësimi do të ishte shumë jo-efektiv, zhurma do të ishte shumë më e madhe e më e rëndësishmja profesorat kishin me pas ma shumë provime me kontrollu, e shpirt kanë edhe ata, gjynah! Arsyet në bazë të të cilave është kërkuar të rritet ky numër janë të pabaza! Nga Kosova dalin 180 mjekë çdo vit, me qindra stomatolog, infermierë, farmacista dhe fizioterapista, ku dojnë me u punësu krejt kta? Mbi 90% e të diplomuarve janë në shpi, ose punojnë nëpër markete a kafiteri (qata edhe kafet ma të mira se kamarierat me fakultet). Nëse jemi duke krijuar kuadro për ti punësuar në Gjermani, si punëtorë shëndetësorë i naj plaku a plake në shtëpi private, bravo na koftë, se mirë ja kemi dalë! Me t'mira!

Kronika Rosé



Fërrkat e Mushtishtit rreth plagjiaturës




Motrat Mustafa dhe Shyhrete Behluli apo të njohura ndryshe nga publiku i gjerë edhe si bilbilat e Mushtishtit i kanë dhënë fund paqes mes tyre duke nisur kësisoji një zënkë përplot me akuza, zënkë kjo që mori vëmendje nga të gjithë ne, përshkak të shqetësimit tonë të madh mbi atë se çfarë në të vërtetë po ndodhte në Mushtisht. Por si qëndron e vërteta?

Ashtu si shprehet edhe Shyhrete Behluli atë e ka "nxan" taksirati pasi Motrat Mustafa e akuzuan se ajo i ka vjedhur këtyre të fundit idenë e këngës së saj për nënën e publikuar më 8 mars 2019. Mirëpo Shyhretja në një intervistë të dhënë për Prive.al refuzon të pranojë që ka vjedhur idenë dhe insiston që e gjithë kjo ngjarje është koiçidencë e jo hajni.

Me apo pa koiçidencë të dy palët kanë publikuar këngë për të njëjtën temë - Nënën. Ne pavarësisht tensioneve te larta mes tyre i bëjmë thirrje palëve që t'i japin fund kësaj zënke sepse fundja edhe pse temat i kanë të njëjta, nënat nuk i kanë të tilla, rrjedhimisht të dy këngët bartin vlera të ndryshme më vete.

Nënat madje i kanë kojshike e ne duam që ato të vazhdojnë ti flasin njëra tjetrës e të bëhen shembull për vajzat e tyre në mënyrë që Mushtishti t'i kthehet kohëve të arta e të mos bie në grackat e agjenturave të huaja të cilat ja kanë zili kësaj vatreje të muzikës e bilbilave.

#LongLiveMUSHTISHTI



Sinteza mes akademisë dhe estradës

Plagjiatura, emëruesi i përbashkët i akademisë dhe estradës, mirëpo tashmë këto dy tabore mendje-ndritur kanë edhe një element tjetër të përbashkët - BimBimma.


Akademia dhe estrada të shkrirë në një e të përfaqësuar nga reperi në fjalë i cili së fundi ka botuar librin e tij të titulluar "PO E ZI" një përmbledhje e këngëve te tij, mirëpo se sa ka qenë e nevojshme një gjë e tillë nuk e dijmë por shpresojmë që të paktën Bimi ta di. Libri i tij nuk kaloi pa vëmendje edhe në panairin e fundit të librit ne Prishtinë (shpresojmë që pazari të ketë qenë i bereqetshëm për Bim-in). Duke e konsideruar vetën jo adekuat dhe duke e parë si barrë të rëndë që të japim vlerësime edhe për akademinë edhe për estradën në të njëjtën kohë (sefte jemi ty u përballë me këso situatash) po ua lëmë juve vlerësimin duke iu ofruar një nga perlat e librit, në "poezinë" e mëposhtme vërtetohet edhe një herë se sa shpejt mund ti "vloj" gjaku një pasaardhësi te pellazgëve. Një eskalim kogja i shpejt nga loja "kukafshehti" në një nacionalizëm triumfues. Shijojeni…

Përpjekjet, mundi dhe dëshira e madhe për plagjiaturë

Profesori i Reumatologjisë, **Sylejman Rexhepi**, autor i librit "Reumatologjia" e botuar ne vitin 2006 është raportuar nga gazeta "Express" se ka përkthyer fjalë për fjalë nga libri "Rheumatologie" i autorit gjerman Hans-Jürgen Hettenkofer.

Rexhepi shprehet se "koha do tregojë se përpjekjet, mundi dhe dëshira e madhe për hartimin e tekstit i kanë përmbushur kërkesat e të interesuarve nga lëmi përkatës". Epo që ka përmbushur kërkesat e të interesuarve nuk mund ta mohojmë veqse s'mund ta mohojmë as faktin që një gjë e tillë është bërë përmes përkthimit e plagjiaturës . (Ta dijmë ku jem)

Ndërkaq profesori Hettenkofer thotë "se po të ndodhte kjo në Gjermani ai do merrte dënim të madh nga universiteti". Kërkojmë falje për zhgënjim por ja që Kosova qëndron më mirë se Gjermania pasi ne njihemi për besën dhe të qenit të mëshirshëm, si çdo herë tjetër UP e suspendoi fillimisht për ta kthyer profën e përpjekjeve të mëdha sërish në detyrë. Besa besë, besën e kem dhanë, këtë universitet me plagjiaturistë kem me lanë! (Marrë nga Admovere)



Mundësitë për orientim të studentëve të rinj

Lyra Hoxha

Di - Dua te di - Mësova është metodë e cila nxit nxënësit të shfaqin atë çfarë ata kanë ditur para se të plotësohet detyra e dhënë. Përdorimi i saj iu ndihmon që të bëjnë parashikime mbi atë që do të mesojnë nëpërmjet pyetjeve që dalin dhe që atyre do t'iu pëlqente t'i përgjigjeshin.

kjo metodë e të mësuarit është treguar po aq e suksesshme sa deklaratat e qeverisë së Kosovës në denuklearizimin e Iranit

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Busulla.com është platforma zyrtare e MASHT-it, e dizajnuar për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë.	Sa reale është paga e një profesioni që asnjëherë s'ka pasur profesionalist të asaj fushe në Kosovë?	
Është fituese e çmimit të Jurisë së Albanian ICT Awards 2017.	Nga janë marrë të dhënat mbi aktualitetin e profesioneve "të reja"?	
Ka LanCuAr edhe aplikacionin e vet për Android/iOS.	Në cilën shkollë të mesme të lartë mund të shkojë një i interesuar që do të punojë audiometrist a furnitor?	
Ndër tjerash ofrohen informata ne lidhje me universitetet e kolegjet ne Kosove, disa shpallje per praktikë e punë dhe profesione 'të pa qena'.	Në cilat institute kombëtare mund të punojnë kozmologët, astronomët e astronautët?	
NARIC Kosova- Qendra kombëtare per njohje te diplomave, ka percaktuar procedurën, dokumentet e aplikimit, por jo dhe kohëzgjatjen për njohjen e diplomave univerzitare ndërkombetare.	Ku saktësisht mund të punojë një inxhinier nanolog?	
	Ku do të mund të kryheshin analizat e ndërtimit të tokës, nga nje gjeolog a teknik i gjeologjisë?	Do të jemi në pritje të një burimi adekuat për të mësuar.

Si i kalova pushimet dimërore

Flamur Sahitolli



Tani kur e mendoja pushimin dimëror dhe po i ktheja ngjarjet në retrospektivë, mbaj mend kur filluam me pushimin por si për çudi nuk mbaj mend a kemi perfunduar me të. Ja pse është shumë e lehtë ta mbash mend se kur filluam. GREVA- ky është titulli që këtë pushim i mbushi portalet, gazetat, televizionet, e kokat tona, kjo është fjala që i la në hije festat e bukura të fund vitit, madje GREVA la në hije edhe fuqinë e letrave të Trumpit. Pra greva e këtij pushimi dimëror ishte kryefjala e fillimit dhe e mbarimit të pushimit. Madje tani kur e mendoj grevën, dhe po shfletoja nëpër faqet e memories, mund të them me plotë përgjegjësinë e fjalës se Rrahmani kah fundi i pushimit fitoi bindshëm vëmendjen e atyre që dikur u bënë kinse të pavëmendshëm në fillimet e saj. Bile është fakt se ai edhe sot e asaj dite vazhdon ta fitojë secilën betejë të re, që përballë ka ata të njëjtët ndaj të cilëve triumfoj herën e fundit. Por kujt i bëhet vonë për grevat, kur bëhet fjalë për pushimet.

Ne si popull i lashtë, me multi-tradita e me nivel kënaqshmërie të kënaqshëm të paktën kështu thotë raporti i lumturisë, e unë dua ti besoj atij raportit, i cili e nxorri Kosovën mirë të ranguar në listat e lumturisë. Pra lumturia është vetë pushimi.

Kam dëgjuar të thuhet se lumturia buron nga dy a tre gjëra, e para nga pushimet, e dyta nga parja dhe e treta por jo nga rëndësia është seksi. Për këtë të fundit nuk jam i sigurt nëse është potencuar seksi si gjini apo seksi si akt, por mbetët për t'u hulumtuar në edicionet e rradhës.

E ky pushim e mori epitetin e pushimeve dimrore, veq at'herë kur festat filluan t'i japin hijeshinë qyteteve. Bredhat, dritat me shumë ngjyra e bora i lumturoi të gjithë, bile sikur raporti i lumturisë të anketonte qytetarët gjatë këtij pushimi jam i sigurt për vendin e parë, në nivel Europian. Edhe pse festat janë për të gjithë, jo të gjitha qytetet patën fatin që këto pushimet dimrore e festat t'i bashkëndjejnë me të tjerët. Festat e pushimit dimëror thuajse nuk u bënë të gjalla në Lipjan, ato mbetën pa drita, e pa bredh. Krejt kjo për arsye të keq menaxhimit e të politikës. Lipjani u la pa festë, si rrjedhojë qytetarët mbetën pa foton tradicionale tek bredhi i qytetit të tyre. E dikush ju gëzua edhe kësaj fatkeqësie, se vetëm falë mungesës së bredhit në qytetin e Lipjanit, bredhi i Prishtinës mbeti edhe këtë herë bredhi më i adhuruar e më i fotografuar.

Është e ditur se në të gjithë botën pushimet dimërore lidhën ngushtë edhe me bredhin edhe me dritat edhe me borën, por sivjet për çudi ky pushim u kap me të gjitha nga pak vetëm me afatin e janarit nuk e pati fatin të bashkëjetoj, e kjo falë superzgjatjes së grevave. Pra pushimet i sollën grevat, e grevat e zgjatën pushimin. E zgjatën edhe afatin e janarit, ani pse janari përfundoi më 1 shkurt. E zgjatjes së pushimit ju gëzuan studentët e afatiti të janarit, ju gëzuan edhe profesorët, madje pa gëzim nuk besoj të kenë mbetur as stafi administrativ. Bile studentët të cilët këto pushime ishin disa orë në skijim diku nëpër bjeshkët e Kosovës, shtyerja e grevës ishte kohë bonus për zgjatjen e pushimeve, e bashkë me të edhe për zgjatjen e afatit të janarit.

Por dikur gjithçkaje i vjen fundi, edhe grevave edhe taksës e edhe pushimit dimëror. Dhe sa për kurajo pushimet dimërore përfunduan për të gjithë, si për ata që ato i kaluan të kënaqur në shtëpi si për ata që ato i kaluan nëpër kodrat e Brezovices a Bogës, bile ato përfunduan edhe për ata që ato i kaluan diku në Sant Moritz të Zvicrës a ku di unë. E tash krejt çka mbeti për historinë nga këto pushime dimrore janë notat që u vizatuan në SEMS, dhe fotografitë pranë bredhit, ato me syze dikund në skajet e rrugëve për Brezovicë, edhe disa shkrime në portale.

fitues i garës së hartimit nga numri i kaluar i TD-së

Tema: 1 tetor 1997 - 1 tetor 2019

Aktivizmi studentor

Shkruaje një hartim për "1 tetor 1997 - 1 tetor 2019"

Për referencë lexoni numrin e dytë të Tempullit të Dijes (hehe)

Hartimin e përfunduar dërgo me email tek: gazeta.orca@gmail.com.

Hartimi më i mirë do të botohet në numrin e ardhshëm të TD.